



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

---

DREJTORIJA E INSPEKTORATIT

<b>Datë :</b>	<b>02.03.2018</b>
<b>Referencë</b>	<b>11-344/2</b>
<b>Për :</b>	<b>Kryetar i Komunës- Imri Ahmeti</b>
<b>Nga :</b>	<b>Drejtori i Drejtorisë të Inspektoratit - Imer Rrustemi</b>
<b>Lënda :</b>	<b>RAPORTI MUJOR-SHKURT</b>



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI KOMUNAL - LIPJAN  
DREJTORATI I INSPEKTORATIT



Pasqyra tabelare e punës për muajin –Shkurt

Inspektorët	Gjithsej	Inspektime me procesverbal	Pranime teknike	Fletëparaqitje për kundërvajtje	Inspektime për pirjen e duhanit	Vërejtje, njoftime	Inspektime për orar te punës	Lëndë e ekzekutuara gjyqësore	Pëiqime sanitare	Menaxhim i tregjeve	Aktivdime- ndalesa,urdhëresa	Mbyllje perkohshme	Kërkesa, pune me palë	Të hyra nga pranimet teknike	Inspektim i kafshëve në thertore	Inspektime me polici	Inspektim për farëra,plehradhe pesticide	Biznese të paregjistruara dhe pa pranime teknike	Mallë me afat të skaduar
Biznesit	245	27	8	3		12	2	1		8	56	4	102	600.00				22	
Ambientit	46	13				2							28			3			
Bujqësisë	120	13				30							60				17		
Ndërtimtarisë	5	2									1		2						
Trafikut	104	17		1		32				6			21			27			
Sanitar	76	27		4	25	11						1	6		2				10L
Gjithsejtë	<u>596</u>	<u>99</u>	<u>8</u>	<u>8</u>	<u>25</u>	<u>87</u>	<u>2</u>	<u>1</u>		<u>14</u>	<u>57</u>	<u>5</u>	<u>219</u>	600.00 €	<u>2</u>	<u>30</u>	<u>17</u>	<u>22</u>	<u>10L</u>

Gjatë muajit shkurt kemi hasur në 12 biznese të pa regjistruara në qendrën e regjistrimit të biznesit ku janë urdhëruar me procesverbal dhe me aktvendim që të bëjnë regjistrimin e tyre pran qëndrese së regjistrimit të bizneseve ARBK-së në Lipjan. Gjithashtu kemi pasur 10 biznese pa pranime teknik të lokaleve afariste për plotësimin e kushteve tekniko higjenike ku janë urdhëruar me procesverbal dhe aktvendim që të aplikojnë për pranime teknik.

Drejtorati jonë ka pasur një aksion së bashku me Inspektoret e ATK-së për lojërat e fatit ku janë mbyllur 4 subjekte afariste kazino dhe bastore sportive ku ndaj të cilëve janë marur masa konform legjislacionit në fuqi.

Një vëmendje të posaçme ju kemi kushtuar barnatoreve humane në lidhje me respektimin e orarit të punës sidomos gjatë natës si dhe gjatë vikendeve. Gjatë kontrolles nuk kemi hasur ndonjë nga barnatoret që nuk e ka respektuar orarin.

Kemi bërë inspektimin e furrave të bukës, ku kemi inspektuar furrat në qytetin e Lipjanit por edhe nëpër fshatra. Të gjitha janë inspektuar në aspektin higjienik dhe kushtet e prodhimit të bukës dhe për të gjitha vërejtjet i është dhënë urdhër për eliminimin e mangësive. Në një prej furrave të bukës për shkak të kushteve higjieno sanitare jo optimale kemi ndaluar ushtrimin e veprimtarisë deri sa ka bërë eliminimin e mangësive-përmirësimin e kushteve tekniko sanitare dhe pastaj kemi lejuar fillimin e prodhimit.

Po ashtu kemi inspektuar edhe disa prej kafiterive, gjatë inspektimit në disa kafiteri është gjetur verë e kuqe si dhe alkool pa deklaracion në sasi prej 10 litra (8 litra verë dhe 2 litra alkool) të cilat menjëherë i kemi asgjësuar në vend dhe ndaj kafiterive (dy kafiteri) në të cilat janë gjetur produktet e lartcekura është bërë kërkesë në Gjykatë për fillimin e procedurës për kundërvajtje (fletëparaqitje), kërkesa për kundërvajtje (fletëparaqitje) janë bërë edhe ndaj dy subjekteve tjera afariste, njëra për mos respektim të urdhëresës së dhenë nga Inspektori si dhe tjetra për mos respektim të Ligjit për Kontrollin e Duhanit.

Në tërësi biznese të ndëshkuara gjatë këtij muaji kanë qenë 8 biznese të cilat janë ndëshkuar me fletëparaqitje për kundërvajtje.

Gjithsejtë biznese të mbyllura gjatë muajit janë 5 biznese ku prej tyre 4 biznese i ka mbyllur Inspektori i Tregut, kurse një biznes Inspektori sanitarë.

Të hyra buxhetore nga Inspektorati janë 600€ për muajin shkurt nga taksat për pranime teknike.

Kemi dalë në teren sipas ankesave të qytetarëve në fshatrat Dobrajë e Madhe, Vrellë, Mirenë, Ribarë i Madh, Magurë në lidhje me mos funksionalizim të rrjetit të kanalizimit dhe dëmtim të pusetave, për të cilat është njoftuar me shkrim Drejtoria e Shërbimeve Publike për problemet që ekzistojnë për sanimin e gjendjes.

Kemi dalë në kontroll tek deponitë ilegale të mbeturinave për gjatë magjistrales Lipjan-Shtime si dhe disa fshatra Babush i Muhaxherëve, Gadime, Kodrën e Kërçevës, se mos po hasen biznese apo qytetarë duke hedhë mbeturina për të marr masat ligjore ndaj tyre. U është dhënë vërejtje dhe urdhëresa firmave ndërtimore për menaxhim më të mirë të mbeturinave inerte, grumbullimin e tyre të shpërndara nga era.

Janë kontrolluar biznese rreth magjistrales Prishtinë-Ferizaj në lidhje se mos po ndotin ajrin me përdorimin gomave të vjetra të automjeteve për ndezje në Kalldajat për ngrohje.

Është bërë inspektimi i disa kompanive të autobusëve që qarkullojnë nëpër Lipjan se mos ka ndonjë vonesë në rende e udhëtimit, si dhe kontrollimi i auto-taksive që janë te parkuar në parkingjet e auto-taksit si në rrugën në disa rrugë të qytetit, si dhe inspektim në Aeroportin Ndërkombëtar “dem Jashari” në Vrellë se po hasim ndonjë duke ushtruar veprimtari ilegale.

Gjatë këtij muaji janë inspektuar barantoret bujqësore dhe shitësit e plehrave minerale me shumicë dhe pakicë, janë inspektuar tokat bujqësore mbi ndërrim destinimin e tyre si dhe ato që po mbushen me materiale te ndryshme, në bashkëpunim me policin kishim aksion mbi dëmtimin e tokave nga mbeturinat dhe materialet e tjera ne regjionin lindor te Komunës.